



## ELEMENTET E DEMOKRACISË JANË BAZA E JETESËS



## SHTËPIA E LIGJEVE

FËLLËNZA (10), RAJMOND (11), ARGJEND (11), ENIS (11), ELDA (10), ARTINA (11), AURON (10),  
ENDRINA (11), VLORA (10), RUDINA (11)



### Të dashur lexues, ky artikull i punuar me shumë dashuri do t'iu informojë më shumë rreth punës të cilën e bën Kuvendi i Republikës së Kosovës

Punëtorinë e filluam me diskutim të përgjithshëm rreth Kuvendit, si dhe me ndarjen e informatave që ne grupi i „Shegës“ i dinim për Kuvendin.

Në ndërkohë sa disa nga anëtarët e grupit vizatonin, pjesa tjetër kontribuonin përmes shkrimit. Ashtu siç u njoftuat nga titulli, sot ne si temë e kemi diskutuar Kuvendin dhe rëndësinë e tij si institucion. Këtë institucion ndryshe e quajmë edhe „Shtëpia e Popullit“, sepse të zgjedhurit e popullit punojnë aty.

Kuvendi e ushtron Pushtetin Legjislativ, sepse bën miratimin (mos miratimin) e ligjeve. Fillimisht këto ligje kur shkojnë tek Kuvendi janë të njohura si projektligje. Pastaj, pas miratimit në Kuvend ato kalojnë në ligje. Të drejtën për të propozuar projektligje përpos deputetëve e ka edhe Qeveria, Presidenti si dhe një numër i madh i qytetarëve. Ndonjëri prej juve mund të pyet se a thua çfarë ndodh me ato ligje të cilat miratohen në Kuvend. Të gjitha këto ligje, menjëherë pas miratimit nga Kuvendi, i dërgohen institucionit të Qeverisë, i cili ka për detyrë vënien në fuqi dhe zbatimin e tyre.

Ne si qytetarë jemi të obliguar t'iu bindemi këtyre ligjeve. Për shembull, ne si qytetarë po ashtu edhe si nxënës, shkollimin e mesëm të ulët e kemi të obliguar. Siç edhe vet po e shihni, ju të dashur lexues, Kuvendi

ndi luan rol shumë të rëndësishëm në jetën e secilit prej nesh. Përpos këtij funksioni, Kuvendi po ashtu mbikëqyr Qeverinë, si dhe funksioni tjetër i këtij institucioni është përfaqësimi i popullit. Në Kuvendin e Kosovës, kuvendojnë 120 deputetë, të cilët janë të zgjedhur direkt nga ana e popullit. Deputetët iu përkasin partive të ndryshme politike, mirëpo, ka edhe deputetë të cilët janë pa parti. Krejt kjo falë frymës demokratike që ky institucion e ka.

Ne, grupi „Shega“, të gjitha këto informata që i ndamë me ju, i bëmë me shumë kënaqësi, si dhe shpresojmë që sado pak t'iu kenë ndihmuar. Po ashtu, jemi shumë të lumtur që në një mënyrë apo tjetrën e kemi rastin të jemi sa më afër jush.



Puna që ne sot e bëmë, ishte punë që e kemi bërë me shumë dashuri

# TË GJITHË JEMI TË BARABARTË

ALBION (11), ANDI (11), ERVIN (10), FLORENTINA (10), EDINA (10), FESTIM (11)

## Të dashur lexues, sot do të flasim për procesin zgjedhor në Kosovën demokratike

Procesi zgjedhor është një ndër proceset më të rëndësishme në Kosovë. Me anë të këtij procesi, secili qytetar mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtë të votojë. Votat janë ato që e përcaktojnë se kush do ta udhëheqë vendin apo popullin e Kosovës për një mandat 4 vjeçar. Procesin e votimit e përdorim edhe ne në klasë, për shembull, me vota e zgjedhim edhe kryetarin e klasës. Nëse një person i përket një komuniteti tjetër, i cili jeton, vepron dhe është i shënuar në regjistrin civil të shtetit të Kosovës, ai ka të drejtë të votojë në zgjedhjet e shtetit tonë. Këtë barazi e mundëson sistemi më i mirë i qeverisjes, që quhet demokraci. Prandaj, iu ftojmë edhe ju qytetarë të dashur të votoni, sepse vota juaj bën ndryshimin. Bëhuni pjesë e ndryshimit, bëhuni qytetarë aktiv.




E ardhmja e Kosovës jemi ne



Të drejtën e votës e kemi të gjithë nga moshë 18 vjeçare



Votimi është proces demokratik



Vota juaj ka vlerë të madhe



Liria është një prej elementeve të demokracisë

# PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E DEPUTETËVE

IBRAHIM (11), ALTIN (11), JONISA (10), RRYTA (10), JETMIRA (10), ERIS (10)

**Të dashur lexues, a e dini se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e deputetëve? Këto informata do t'i mësoni në artikullin më poshtë**

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kanë disa detyra dhe përgjegjësi, të cilat duhet t'i kryejnë me kujdes dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. Një prej detyrave të deputetëve është përfaqësimi i popullit në Kuvend. Deputetët në Kuvend propozojnë dhe miratojnë ligjet. Këto ligje, kanë ndikim të madh në jetën tonë. Për shembull, ligjet që merren për edukim janë ndër ligjet më të rëndësishme për neve, nxënësit që jemi përfituesit e sistemit arsimor.

Siç e dini, deputetët zgjedhen nga populli, prandaj populli kërkon që këta deputetë të jenë të drejtë dhe të marrin vendime të mira për popullin.

Por, edhe ne duhet t'i ndihmojmë atyre. Një nga mënyrat se si ne mund t'i ndihmojmë deputetëve është duke i respektuar ligjet.



Gazetarët e së ardhmes




Së bashku, kontribuojmë në demokraci



Një deputete duke folur para popullit



Të gjithë jemi të barabartë



Të bashkuar për një të ardhme të ndritur

## PUNA E PËRBASHKËT

ENSAR I. (10), ENSAR Z. (10), AGON (10), KALTRINA (11), BLINERA (11), ALMIRA (10), FUAD (11),  
AMIRA (10), KRENARE (10)



**Ne këtu në Punëtorinë e Demokracisë, kemi ardhur dhe jemi bërë gazetarë të demokracisë. Prandaj, në këtë artikull do të lexoni për temën e ndarjes së pushtetit**

Në fillim të Punëtorisë, ne bëmë shumë aktivitete dhe lojëra të ndryshme. Pasi u shpallëm gazetarë të demokracisë, ne u ndamë në grupe. Tema e grupit të

për detyrë të na mbrojnë neve, qytetarët e Kosovës. Gjykatat janë institucione gjyqësore. Këto institucione, merren me ndarjen e drejtësisë dhe me personat për të cilët dyshohet se kanë shkelur ligjet. E në fund, Kushtetuta është libri kryesor i një shteti demokratik, ku bazohen ligjet e reja dhe gjithçka që ndodh në shtet. Të gjitha këto institucione nuk duhet të punojnë së bashku, por duhet të punojnë të ndara.

Çdo njeri duhet të mësoj për të arritur diçka të vlefshme në jetë. Nëse secili punon sa më mirë dhe ka detyrë të qartë, atëherë të gjithë së bashku mund të arrijmë diçka të madhe në jetë. Kjo ndodhi edhe tek ne sot në grupin e gazetarëve „Molla“.



vogël ishte ndarja e pushtetit. Ne në grup mësuam kuptimin e fjalës demokraci, e cila do të thotë popull udhëheqës. Dega e parë e pushtetit mbi të cilën diskutuam ishte Kuvendi. Kuvendi është institucion legjislativ që vë ligjet. Deputetët kanë për detyrë të miratojnë ligjet. Prandaj, Kuvendi është Pushteti Legjislativ. Ndërsa, Qeveria përfaqëson Pushtetin Ekzekutiv. Ky institucion ka përgjegjësi të ekzekutojë dhe të zbatojë ligjet. Në Qeveri punojnë Kryeministri, ministrat zëvendësministrat, etj. Kurse, Policia e Kosovës ka



Gazetarët e grupit „Molla“



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Mustafë Venhari“  
Klasa: V-3  
Vendi: Vushtri